



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**

---

**C.nr.459/2012**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, gjyqtari Naim Kurtishi, me bashkëpunëtorin profesional Malsor Kryeziu, në kontestin e paditësit A. K. nga P., rr...., nr...., të cilin me autorizim e përfaqëson av. V. O., nga P., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari K. P. jurist i Kompanisë, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 3000 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 24.02.2015, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET PJESËRISHT** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A. K. nga Prizreni dhe **OBLIGOHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria”, me seli në P., që në emër të dëmit material dhe atij jo material, t’ia kompensoj paditësit shumë si në vijim:

Paditësit **A. K.:**

- Për dhimbje fizike (trupore) shumë prej 700 euro
- Për frik shumë prej 500 euro.
- Për ndihmë nga personi i tretë shumë prej 70 euro
- Për ushqim të përforcuar (10 ditë) shumë prej 30 euro, respektivisht shumë e përgjithshme prej 1300 euro, me kamatë sikurse për mjetet e deponuara për një vit pa destinim të caktuar në Bankat Komerciale të R. Kosovës duke e llogaritur atë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi dt.24.02.2015, e deri te pagesa definitive të gjitha këto brenda afatit 15 ditor pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

**II. OBLIGOHET** e paditura që t’ia paguajë paditësit shpenzimet procedurale dhe atë në lartësi prej 450 € në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

**III.** Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit A. K., mbi shumë e aprovuara sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi, **refuzohet si e pabazuar.**

## Ar sy e t i m

Paditësi A. K. nga P., pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë për kompensimin e dëmit, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigal”, me seli në P., duke theksuar se me datën 15.03.2011 ne rrugën magjistrale Sh. –S. përkatësisht në fsh. C. në afërsi të pompës së benzinës “L. P.” në kthesën e djathtë ngasësi i veturës Markës “Ford” në momentin kritik ishte duke u drejtuar nga vozitësi G. H. ashtu që duke mos iu përshtatur shpejtësisë dhe kushteve e rrethanave të rrugës, del humb kontrollin në automjetin e tij dhe kalon në shiritin tjetër duke e goditur në mënyre direkte në automjetin e markës “Mercedes”, me targa *numri i targës...*, veturë e cila ishte duke vozitur në drejtim të kundërt, duke i shkaktuar lëndime trupore vozitësit A. M. K. të përshkruara në raportin mjekësor. Duke u bazuar në LMD i kanë propozuar gjykatës që të merr aktgjykim me të cilin do të aprovohet kërkesëpadia e paditësit A. K., si e bazuar dhe do të obligohet e paditura KS “Sigal Uniqa Group Austria”, nga P. të kompensoj paditësit dëmin jo material dhe material të shkaktuar në aksidentit e komunikacionit në shumën e përgjithshme prej 5570 euro, me kamatë ligjore prej 12% duke e llogaritur nga data e pranimit të aktgjykimit e deri në pagesën definitive si dhe kompensimin e shpenzimeve procedurale.

Edhe përgjatë shqyrtimit kryesor, i autorizuari i paditësit av. V. O., nga P., ka deklaruar se mbetet pranë padisë, kërkesëpadisë të parashtruar në formë të shkruar si dhe nga të dhënat nga shqyrtimet e mbajtur me propozim aprovimin e kërkesëpadisë. I njëjti i deponon gjykatës precizimin e kërkesëpadisë në formë të shkruar në dy kopje një për gjykatën një për palën përmesë të cilës thekson se në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësit A. K., kundër të paditurës K.S “Sigal”, nga P. në lëndën e kontestit kompensim dëmi, janë marrë mendimet e mjekëve ekspert, lidhur me shkallën e lëndimeve trupore, si dhe shkallën e frikës së pësuar nga paditësi në aksidentin e komunikacionit të dt.15.03.2011. Në këtë rrethanë i autorizuari i paditësit bënë precizimin e kërkesëpadisë, duke i propozuar gjykatës që të merr aktgjykim me të cilin aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit si e bazuar dhe obligohet e paditura K.S. “Sigal” që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial ti paguaj paditësit shumën dhe atë: për dhimbje fizike shumën prej 1500 euro, për frikë shumën prej 1500 euro, për ndihmën e personit të huaj shumën prej 200 euro, për ushqim të përforcuar shumën prej 50 euro si dhe shpenzimet e mjekimit shumën prej 200 euro si dhe fitimin e humbur shumën prej 800 euro, respektivisht shumën e përgjithshme prej 4550 euro duke e llogaritur kamatën ligjore prej ditës së parashtrimit të padisë gjer në pagesën definitive, shpenzimet e procedurës sipas tarifës së OAK-së për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro, përfaqësimi për një seancë shumën prej 135 euro për aq seanca sa do të jenë deri në përfundim të kësaj çështje kontestimore si dhe shpenzimet për nxjerrjen e provës nga ana e ekspertëve mjekësor në shumën prej 200 euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunëshëm. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me administrimin e provave të rpopozuara dhe administruara në këtë çështje juridike kontestimore pa mëdyshje u vërtetua përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit andaj edhe i propozoj gjykatës që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit A. K. e precizuar ,e parashtresën e dt.24.02.2015. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas specifikacionit e cila është pjesë e petitumit të kërkuar për aprovim.

Përmes përgjegjës me shkrim në padi të datës 14.08.2014, e paditura Kompania e Sigurimeve "Sigal" nga P., nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë së paditësit, ndërsa sa i përket shumës së kompensimit e ka rezervuar të drejtën që të deklarohet më vonë.

Gjatë shqyrtimit kryesor i autorizuari i të paditurës ka deklaruar se ngelë në tërësi në të dhënat që janë cekur gjatë shqyrtimeve të mbajtura në vazhdimësi, në të dhënat e cekura në përgjigjen e shkruar me propozim refuzimin e kësaj kërkesëpadie, e njëherit tani pasi që pala er paditur ka prnuar parashtresën e precizuar të kësaj kërkesëpadie deklaroi: Sa i përket parashtresës së të autorizuarit të paditësit për precizimin e kërkesëpadisë e kontestojmë pjesërisht sepse shumat e precizuara nuk janë në harmoni në aspektin e lartësisë me kriteret por nuk janë pjesërisht në harmoni edhe me mendimin e ekspertit neuropsikiatër, ndërkaq sa i përket të gjitha formave të dëmit material si në precizim janë të pabazuara përkatësisht nuk janë paraqitur prova materiale për asnjërën nga këto forma. Ndërkaq sa i përket në vazhdim kërkesë për kamat ligjore që është kërkuar nga data e parashkrimit të padisë gjerë në pagesën definitive po ashtu e kundërshtojmë sepse kamata ligjore rrjedhe nga data e marrjes së aktgjykimit me qe kemi të bëjmë me dëm jo-material. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar nuk e kontestojmë bazën juridike të kërkesëpadisë por vetëm lartësinë e saj ashtu që për dy format e dëmit jo material si dhembja fizike dhe frika e paditura ofron ofertë në lartësi prej 1000 Euro ndërkaq për të gjitha format tjera të dëmit material në mënyrë absolute nuk janë paraqitur asnjë prove materiale për të justifikuar shpenzimet e krijuara përkatësisht edhe të kërkuara si në precizimi sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore propozojmë gjykatës zbatimin e nenit 452 al.2 të LPK-së.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim ka bërë: leximin e ekspertizës nga ana e ekspertit Dr. N. F. psikiatër dt. 26.12.2014, leximin e ekspertizës se ekspertit mjeko-ligjor Dr. Xh. K. - ortoped traumatolog, dt. 24.12.2014 dhe më pas edhe dëgjimin e ti, leximi i raportit të policisë me nr. 2001-GR-0241, dt. 15.03.2011, leximi i raportit mjekësor me nr. protokollit 7217 dt. 15.02.2011,

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të theksuara më lartë në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), duke i çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit **është pjesërisht e bazuar.**

Gjykata me leximin e raportit të shkruar dhe të deponuar në gjykatë nga ana e ekspertit Dr. N. F. psikiatër lidhur me paditësin A. K. , i caktuar si ekspert për shkak se paditësi ka pësuar lëndime, i cili bazuar në dokumentacionin mjekësor që gjendet në shkresat e lëndës dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka vërtetuar faktin se paditësi A. K., në aksidentin e ndodhur ka përjetuar edhe frikë primare që ka zgjatur 1 minutë e karakterizuar me një vërshim intensive emocionale për mundësin e vdekjes. Këtë e konstatojmë në bazë të një gjendje të mpirjes te plot emocionale të përshkruar nga ana e paditësit të shfaqur në momentin kur ka vërejtur përballjen e makinës dhe ka ngelur "pa frymë" dhe si " i humbur". Po ashtu ka përjetuar edhe frikë sekondare të intensitetit të lartë një dite e manifestuar si shqetësim intensiv nga rasti si dhe si brengosje intensive për mundësin e përfundimit tragjik. Ka pësuar frikë sekondare e intensitetit të mesëm një muaj, e manifestuar si me prishje të gjumit nervozizëm mendime negative, mbylljen në

shtëpi, plogështi dhe dridhje, kjo frikë përmbahej edhe nga vështirësia në ecje dhe nga dhembjet e kohëpaskohshme. Kurse mund të konstatohet edhe frikë sekondare me intensitetit të ultë që ka vazhduar për rreth gjashtë muajt tjerë e manifestuar me rikujtime traumatike të momentit të lëndimit, indisponimit, dëshprimit, intermitent, iritabilitet, mbydhje në vete dhe mungesë të vullnetit.

Me leximin e raportit të shkruar nga eksperti Dr. Xh. K.-Ortoped-Traumatolog, lidhur me paditësin A. K., gjykata ka vërtetuar faktin se në aksident e ndodhur me dt.15.03.2011, paditësi ka pësuar lëndime trupore: Ndrydhje të gjoksit, ndrydhje të shpatullës djathtas dhe dorës së parakrahut të djathtë, lëndime të klasifikuara si lëndime të lehta trupore. Gjatë lëndimeve personi në fjalë ka pësuar dhimbje fizike dhe atë: dhimbje të intensitetit të shkallës së lartë: 5 orë kohë pas kohë deri të marrja e terapisë (aksidenti 9-30 min kontrolli në QKUK 13-30 min.), dhimbje të intensitetit të mesëm një muaj ku verifikohet me raportet e vizitave mjekësore, dhimbje të intensitetit të ulët dy muaj, shëmtim trupor nuk ka, zvogëlim i aftësisë jetësore e përkohshme për punë dy muaj, ndihma e personit të tretë: një muaj për veshje, higjienë personale, ushqim i sforcuar me proteinë e vitaminë 10 ditë më shumë 5 Euro në ditë, mjekimi me barna: për dhimbje, antiedematoza dhe miorelaksante: dy muaj, ku vërehet nga vizitat mjekësore, veshmbathje të butë dhe komode jo shtrënguese xhemper dhe pallto – xhup të madhësisë përkatëse.

Me leximin e raportit të policisë me nr.2011-GR-241 i dt. 15.03.2011 si dhe shikimin e skicës dhe fotot e deponuara që janë pjesë e raportit të policisë së trafikut të vendit të ngjarjes, gjykata ka vërtetuar faktin se deri të aksidenti i trafikut ka ardhur kur automjeti “A” ishte duke lëvizur nga Sh. në drejtim të S. dhe kur arrin në C. në afërsi të pompës “L. P.” në kthesë nga e djathta nga drejtimi i lëvizjes së tij ngasësi “A” duke mos iu përshtatur shpejtësinë e kushteve dhe rrethanave të rrugës ( koha duke rënë shi) humb kontrollin në automjetin e tij dhe kalon në shiritin e kundërt duke e goditur direkt në pjesën e përparme të automjetit “B” i cili ishte duke lëvizur nga drejtimi i kundërt drejt në shiritin e vet lëvizës. Në këtë aksidente lëndime marrin të dy ngasësit “A” dhe “B” lidhur me natyrën pasojnë lëndime të lehta trupore.

Me nenin 154 al.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se **“kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftëse nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”**, ndërsa me nenin 178 të po këtij ligji është paraparë se **“në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar për faj të një poseduesi të automjetit, vihen në zbatim rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë”**.

Në bazë të lartcekurave gjykata ka vërtetuar se e paditura është pjesërisht përgjegjëse ndaj këtu paditësi konform përgjegjësisë në bazë të fajësisë, të paraparë me dispozitat e lartë cituara të nenit 178 al.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) dhe dispozitave mbi kompensimin e dëmit konform shkallës së përgjegjësisë së tyre për dëmin material të shkaktuar, e të parapara me dispozitat e nenit 189 al.2 të LMD-së, si dhe dëmit jo material konform nenit 200 të LMD-së, e lidhur me nenin 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK). Në lidhje me kërkesat e aprovuara në shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata është e mendimit se të njëjtat janë adekuate, duke marrë parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësit dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësoj të

dëmtuarit – këtu paditësit, satisfaksion që ai të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensojë të mirat jo materiale nga të cilat është privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën ai do ta kishte po qesë të njëjtat nuk do t'i kishte humbur, e krejt kjo duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intenzitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre, kohën e nevojshme të shërimit dhe nevojat e shtuara të ushqimit, respektivisht pasojat e lëndimeve më afër të përshkruara si në mendimin e ekspertit dr. Xh. K., Ortoped – traumatolog si dhe ekspertit Dr. N. F. psikiatër. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial, si dhe në lidhje me shumën kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash, gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkëljes së të mirave dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe faktin se me të njëjtin, të mos u shkoj përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e këtij kompensimi dhe qëllimin e tij shoqëror.

Gjykata nuk i morri për bazë theksimet e të autorizuarit të paditurës se kërkesa respektivisht shumat e kërkuara janë tejet të larta dhe nuk janë në harmoni me lëndimet e pësuar, si dhe propozimin që pala e paditur është e gatshme që ti paguaj paditësit në emër të dëmit jo material ti kompensoj shumën e përgjithshme prej 1.000 euro, ndërsa mbi këtë shumë që të refuzohet kërkesëpadi, kurse për dëmin material dhe fitimin e humbur të refuzohet kërkesëpadi, pasi që një propozim i tillë nuk korrespondon me dëmin të cilin e ka pësuar paditësi si dhe se duke marrë parasysh lartësinë e shumës së të hollave që në emër të kompensimit, do t'i mundësoj të dëmtuarit – këtu paditësit, satisfaksion që ai të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensojë të mirat jomateriale nga të cilat është privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën ai do ta kishte poqëse të njëjtat nuk do t'i kishte humbur, e krejt kjo duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre, kohën e nevojshme të shërimit dhe nevojat e shtuara të ushqimisë.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese respektivisht shumës mbi shumat e aprovuara, gjykata të njëjtat i refuzoi ngase konsideroi se shumat e kërkuar mbi shumën e aprovuar është mbi shumën e cila nevojitet që gjendja materiale e të dëmtuarve të sillt aty ku do të ishte po mos të kishte ndodhur veprimi dëmtues. Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vlerëson se shumat e kërkuara me kërkesëpadi përtej shumave të aprovuara, nuk janë reale dhe se të njëjtat nuk i përgjigjen shkallës së përgjegjesisë deliktore civile të të paditurës.

Gjykata ka vlerësuar dhe theksimet tjera të palëve ndërgjyqëse, provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës posaçërisht të institucioneve shëndetësore, por meqenëse të njëjtat janë shfrytëzuar nga ekspertet për të përgatitur ekspertizat mjeko-ligjore, gjykata konsideroi se të njëjtat veç janë administruar dhe nuk ka nevojë që të administrohen veç e veç se edhe po të administroheshin veç e veç të njëjtat nuk do të ishin me ndikimin që në këtë çështje të vendosej ndryshe.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në bazë të nenit 452.2 të LPK-së dhe atë duke marrë parasysh suksesin e arritur në këtë procedurë.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së..

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**C.nr.459/12, datë 24.02.2015**

**Bashkëpunëtori profesional,**  
**Malsor Kryeziu**

**Gjyqtari,**  
**Naim Kurtishi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjës së të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.